

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar

P9

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 24.01.2026

1. Tregu i Ri sh.a gjatë viteve ka ndjekur një strategji rritjeje përmes blerjeve të kompanive brenda industrisë prodhuese.

Draft-pasqyrat e pozitës financiare të Tregu i Ri sh.a dhe të kompanive në të cilat ka investuar Preveza sh.a dhe Rozhaja sh.a më 31 dhjetor 2025 janë si më poshtë:

	Tregu i Ri	Preveza	Rozhaja
	€'m	€'m	€'m
Pasuritë			
<i>Jo-qarkulluese</i>			
Pasuritë e patundshme, impiantet dhe pajisjet	500	375	425
Investimet në:			
Preveza	300		
Rozhaja	<u>230</u>	<u>150</u>	<u>-</u>
	1,030	525	425
Qarkulluese	<u>150</u>	<u>175</u>	<u>200</u>
Total pasuritë	1,180	700	625
Ekuiteti dhe detyrimet			
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	250	125	125
Fitimet e mbajtura	580	400	350
Rezervat tjera	<u>100</u>	<u>50</u>	<u>100</u>
	930	575	575
Detyrimet afatgjata	150	75	30
Detyrimet afatshkurta	<u>100</u>	<u>50</u>	<u>20</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,180	700	625

Informata shtesë:

- i) Tregu i Ri sh.a bleu 60% të ekuitetit të Preveza sh.a më 1 janar 2020 me një kosto prej €250 milionë, kur fitimet e mbajtura dhe rezervat e tjera të Preveza sh.a arritën përkatësisht në €230 milionë dhe €32.5 milionë. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Preveza sh.a më 1 janar 2020 ishte €400 milionë. Diferenca midis vlerës së drejtë dhe vlerave kontabël të pasurive neto të identifikueshme të Preveza sh.a më 1 janar 2020 i atribuohet një elementi të impiantit i cili kishte një jetë të mbetur ekonomike të dobishme në atë datë prej tetë (8) vitesh.

Një pronësi prej 40% në Preveza sh.a kishte një vlerë të drejtë prej €167 milionë në atë datë. Tregu i ri sh.a ka zgjedhur të zbatojë metodën e zërit të mirë të plotë (metoda e vlerës së drejtë) në lidhje me të gjitha investimet e saj.

- ii) Tregu i Ri sh.a bleu 35% të kapitalit të Rozhaja sh.a më 1 janar 2023 me një kosto prej €100 milionë, kur fitimet e mbajtura dhe rezervat e tjera të Rozhaja sh.a arritën përkatësisht në €100 milionë dhe €25 milionë. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Rozhaja sh.a më 1 janar 2023 ishte e barabartë me vlerat e tyre kontabël. Pronësia prej 35% i dha Tregu i Ri sh.a-së një influencë domethënëse në Rozhaja sh.a.

- iii) Preveza sh.a bleu 20% të ekuitetit të Rozhaja sh.a më 1 janar 2024 me një kosto prej €125 milionë, kur fitimet e mbajtura dhe rezervat e tjera të Rozhaja sh.a arritën përkatësisht në €300 milionë dhe €75 milion. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Rozhaja sh.a më 1 janar 2024 ishte €550 milionë. Diferenca midis vlerës së drejtë dhe vlerave kontabël të pasurive neto të identifikueshme të Rozhaja sh.a më 1 janar 2024 i atribuohet një elementi të impiantit i cili kishte një jetë të mbetur ekonomike të dobishme në atë datë prej dhjetë (10) vitesh.

Vlera e drejtë e një pronësie prej 35% në Rozhaja sh.a më 1 janar 2024 ishte €218.8 milionë, ndërsa ajo e një pronësie prej 47% dhe një pronësie prej 53% ishte përkatësisht €293.8 milionë dhe €331.3 milionë.

- iv) Të gjitha pasuritë e investimeve në ekuitet janë klasifikuar si zëra të Vlerës së Drejtë nëpërmjet të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse (VDNTTGj) në pasqyrat financiare të veçanta të entiteteve më sipër në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*.
- v) Stoqet në fund të Preveza sh.a. më 31 dhjetor 2025 përfshijnë stoqe të blerë nga Rozhaja sh.a. me një çmim prej €25 milionë. Rozhaja sh.a. faturon Preveza sh.a. me një marzhë mbi kosto prej 25%.
- vi) Nuk kishte pasur humbje nga dëmtimi në lidhje me investimet në Preveza sh.a dhe Rozhaja sh.a para 1 janarit 2025. Një rishikim për dëmtim të investimeve më 31 dhjetor 2025 tregon se shumatat e rikuperueshme të Preveza sh.a dhe Rozhaja sh.a si njësi gjeneruese të parave më 31 dhjetor 2025 janë përkatësisht €550 milionë dhe €650 milionë.
- vii) Pasuritë e patundshme, impiantet dhe pajisjet të Tregu i Ri sh.a-së përfshijnë një ndërtesë që u ble më 1 janar 2015 me një kosto prej €55 milionë. Ndërtesa zhvlerësohet gjatë një jetëgjatësie totale prej 50 vitesh në bazë lineare me një vlerë të mbetur zero. Ndërtesa u rivlerësua për herë të fundit më 31 dhjetor 2023 me një vlerë të drejtë prej €44 milionë. Ndërtesa ende nuk është rivlerësuar më 31 dhjetor 2025 me një vlerë të drejtë prej €43.5 milionë.

Kërkohet:

Përgatitni pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të grupit Tregu i Ri sh.a më 31 dhjetor 2025.

(30 pikë)

1.

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare të grupit Tregu i Ri sh.a me 31 dhjetor 2025

Pasuritë	€'m
<i>Jo-qarkulluese:</i>	
Pasuritë e patundshme, impiantet dhe pajisjet (LL1)	1,341.6
Zëri i mirë (L12)	<u>40</u>
	1,381.6
Qarkulluese (150+175+200-25X25/125)	<u>520</u>
	1,901.6

Ekuiteti dhe detyrimet

<i>Ekuiteti:</i>	
Kapitali aksionar	250
Fitimet e mbajtura (L14)	571.5
Rezervat tjera (L15)	<u>140.4</u>
Ekuiteti i atribuar pronarëve të prindit	961.9
Interesat jo-kontrollues (L16)	<u>514.7</u>
Total ekuiteti	1,476.6
Detyrimet afatgjata (150+75+30)	255
Detyrimet afatshkurta (100+50+20)	<u>170</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,901.6

Llogaritjet:

L11. Pasuritë e patundshme, impiantet dhe pajisjet	€'m
Shumat e dhëna:	
Tregu i Ri sh.a	500
Preveza sh.a	375
Rozhaja sh.a	<u>425</u>
	1,300
Korrigjimet:	
Përfitimet e vlerës së drejtë në blerjen e:	
Preveza sh.a (400-[125+230+32.5])	12.5
Rozhaja sh.a (550-[125+300+75])	50
Zhvlerësimi i akm në përfitimet e VD:	
Preveza sh.a 12.5/8X6	(9.4)
Rozhaja sh.a 50/10X2	(10)
Rivlerësimi i PPIP të Tregu i ri sh.a (43.5-44X39/41)	1.6
Preveza sh.a humbja e atribuar tek PPIP (L13)	<u>(3.1)</u>
	1,341.6

L12. Zëri i mirë në blerjen e:

i) Preveza sh.a	€'m
Kosto e blerjes	250
IJK në blerje	167
Minus VD e pasurive neto të identifikueshme në blerje	<u>(400)</u>
Zëri i mirë në blerje	17
Minus humbja nga dëmtimi (L13)	<u>(17)</u>
Shuma bartëse me 31 dhjetor 2025	-

ii) Rozhaja sh.a €'m

Kosto e blerjes (218.8+60%X125)	293.8
IJK në blerje (VD e pronësisë 53%)	331.3
Minus VD e pasurive neto të identifikueshme në blerje	(550)
Zëri i mirë në blerje	75.1
Minus humbja nga dëmtimi	<u>(35.1)</u>
Shuma bartëse me 31 dhjetor 2025	40

L13. Rishikimi i Preveza sh.a dhe Rozhaja sh.a si NJGJP për dëmtim:**i) Preveza sh.a** €'m

Shuma bartëse me 31 dhjetor 2025:	
Identifikueshme:	
E dhenë (ekuiteti)	575
Përfitimi i VD neto (12.5-9.4)	3.1
Anulimi i përfitimit nga investimi në Rozhaja sh.a (150-125)	<u>(25)</u>
	553.1
Zëri i mirë	<u>17</u>
Total	570.1
Shuma e rikuperueshme (e dhenë në pyetje)	<u>550</u>
Total humbja (570.1-550)	20.1
Alokuar tek zëri i mirë	<u>(17)</u>
Saldo e alokuar tek PPIP	3.1

ii) Rozhaja sh.a €'m

Shuma bartëse me 31 dhjetor 2025:	
Identifikueshme:	
E dhenë (ekuiteti)	575
Përfitimi i VD neto (50-10)	40
Fitimi i përealizuar 25X25/125	<u>(5)</u>
	610
Zëri i mirë i shtuar (bruto)	<u>75.1</u>
Total	685.1
Shuma e rikuperueshme (e dhenë në pyetje)	<u>650</u>
Total humbja (685.1-650)	35.1
Alokuar tek zëri i mirë (maksimum)	<u>(35.1)</u>

L14 Fitimet e mbajtura të grupit

		€'m
Tregu i Ri sh.a FM		580
Pjesa e FM pas blerjes së:		
Preveza sh.a 60%(400-230)		102
Rozhaja sh.a (35%[300-100]+47%[350-300])		93.5
Korigjimet:		
Anulimi i përfitimit ne rimatjen e pasurive VDNFH		
- Investimet e Tregu i Ri sh.a-së në Preveza sh.a (300-250)		(50)
- Investimet e Tregu i Ri sh.a-së në Rozhaja sh.a (230-100)		(130)
- Investimet e Preveza sh.a-së në Rozhaja sh.a (150 – 125)X60%		(15)
Përfitimi në largimin e Rozhaja sh.a si ortakëri:		
Vlera e drejtë në datën e largimit	218.8	
Shuma bartëse e ortakërisë (vlera e ekuitetit):		
Kosto	100	
Pjesa pas blerjes e		
FM 35%(300-100)	70	
Rezervat tjera 35%(75-25)	<u>17.5</u>	
		<u>(187.5)</u>
		31.3
Zhvlerësimi i akm. i VD:		
- Preveza sh.a 9.4X60%		(5.6)
- Rozhaja sh.a 10X47%		(4.7)
Fitimi i perealizuar në stoqet në fund 5X47%		(2.4)
Rivlerësimi i PPIP të Tregu i Ri sh.a-së:		
Total përfitimi (L1)		1.6
VD në rivlerësim		43.5
Shuma bartëse sipas modelit të kostos 55X39/50		42.9
Shuma para rivlerësimit 44X39/41		41.9
Shuma që duhet të raportohet në F/H (pra FM) (42.9-41.9)		1
Humbjet nga dëmtimi (L13):		
- Zëri i mirë në Preveza sh.a 60%X17		(10.2)
- Zëri i mirë në Rozhaja sh.a 47%X35.1		(16.5)
- PPIP në Preveza sh.a 60%X3.1		<u>(1.9)</u>
		571.5

L15. Rezervat tjera

		€'m
Rezervat tjera të Tregu i Ri sh.a		100
Pjesa e FM pas blerjes së:		
Preveza sh.a 60%(50-32.5)		10.5
Rozhaja sh.a (35%[75-25]+47%[100-75])		29.3
Rivlerësimi i PPIP të Tregu i ri sh.a:		
Total përfitimi (L1)	1.6	
Minus përfitimi në F/H (L14)	(1)	<u>0.6</u>
		140.4

L16. IJK në

i) Preveza sh.a

	€'m
Në blerje	167
Ndryshimet pas blerjes:	
FM 40%(400-230)	68
VD zhvlerësimi 40%X9.4	(3.8)
Anulim i përfitimit në investimet në Rozhaja sh.a 40%(150-125)	(10)
Pjesa e kostos së investimit të Preveza sh.a-së Rozhaja sh.a 40%X125	(50)
Humbja nga dëmtimi në rishikimin e Preveza sh.a si një NjGjP:	
Humbja e zërit të mirë 40%X17	(6.8)
PPIP 40%X3.1	(1.2)
Rezervat tjera 40%(50-32.5)	<u>7</u>
	170.2

ii) Rozhaja sh.a

	€'m
Në blerje	331.3
Ndryshimet pas blerjes:	
FM53%(350-300)	26.5
VD zhvlerësimi 53%X10	(5.3)
Humbja e zërit të mirë 53%X35.1	(18.6)
Fitimi i porealizuar 53%X5	(2.7)
Rezervat tjera 53%(100-75)	<u>13.3</u>
	344.5

2. Ju jeni anëtar i Shoqatës së Kontabilistëve dhe Auditorëve të Çertifikuar të Kosovës (ShKÇAK). Juve ju janë dhënë skenarët e mëposhtëm mbi çështjet etike me të cilat përballen kontabilistët:

- i) Drejtori Ekzekutiv i një kompanie e informoi kontabilistin, i cili është anëtar i ShKÇAK, që të regjistronte disa nga shpenzimet që ai (domethënë Drejtori Ekzekutiv) kishte bërë në disa restorante, si shpenzime marketingu. Drejtori Ekzekutiv theksoi se këto shpenzime ishin bërë për të takuar disa klientë të rëndësishëm, por nuk dha asnjë dokument mbështetës. Ai i tregoi më tej kontabilistit se aprovimi përfundimtar për rritjen e pagës së tij (domethënë të kontabilistit) ende nuk është aprovuar prej tij. Kontabilisti pranoi të regjistronte shpenzime të tilla sipas udhëzimeve të Drejtorit Ekzekutiv.
- ii) Një kontabilist profesionist (një anëtar i ShKÇAK), i cili ofronte shërbime të ndryshme këshillimore për shumë klient të ndryshëm, mori një detyrë këshillimi për tatime që kërkonte njohuri të azhurnuara të ligjeve të tatimeve për minerat. Ky kontabilist nuk zotëron aftësitë dhe ekspertizën e nevojshme për të ofruar shërbimin e kërkuar. Megjithatë, pa e shpalosur këtë fakt, ai e ndërmoi detyrën pasi mund të fitonte një tarifë për këtë angazhim.
- iii) Një Menaxher Financiar, i cili është anëtar i ShKÇAK, që punon në një kompani ka zgjedhur disa entitete të listuara në bursë për investimin e fondeve të kompanisë. Një entitet i tillë, në të cilin do të bëhet investimi më i madh, është një klient kyç i një firme këshillimore, të quajtur Albanian Advisory. Gruaja e Menaxherit Financiar është pronare e Albanian Advisory.

Kërkohet:

- i) **Shpjegoni dy (2) parime themelore etike të shkelura në secilin prej tre (3) skenarëve të mësipërm sipas Kodit të Etikës të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC) të adoptuar nga Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Çertifikuar të Kosovës (ShKÇAK). (6 pikë)**
- ii) **Diskutoni shkurtimisht një (1) kërcënim të lidhur me parimet etike të shkelura në secilin prej tre (3) skenarëve. (4 pikë)**

2.

(i) Shkelje të parimeve themelore etike

Skenari 1

- Integriteti: Kontabilisti që regjistron shpenzimet pa shpjegime mbështetëse nuk mund të konsiderohet i ndershëm dhe i drejtë.
- Objektiviteti: Kontabilisti nuk mund të tregojë se nuk ka lejuar paragjykime, konflikt interesi.
- Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur: Lejimi i regjistrimit të një shpenzimi pa shpjegime mbështetëse nuk mund të konsiderohet si veprim me kujdes të duhur.
- Sjellje profesionale: Duke vepruar kështu, kontabilisti diskrediton profesionin.

Skenari 2

- Integriteti: Kontabilisti që ndërmerr detyrën pa shpalosur faktin se i mungojnë aftësitë dhe ekspertiza e kërkuara, nuk mund të konsiderohet i ndershëm dhe i drejtë.
- Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur: Pranimi i punës pa pasur aftësitë dhe njohuritë e nevojshme nuk mund të konsiderohet si veprim me kujdesin të duhur.
- Sjellja profesionale: Duke vepruar kështu, kontabilisti diskrediton profesionin.

Skenari 3

- Integriteti: Menaxheri financiar që zgjedh një kompani për investimin e fondeve të kompanisë, për shkak të avantazhit financiar që ka gruaja e tij, nuk mund të konsiderohet i ndershëm dhe i drejtë.
- Objektiviteti: Menaxheri financiar nuk mund të tregojë se nuk ka lejuar paragjykime, konflikt interesi.

(ii) Kërcenimet etike

Skenari 1

- Interesi vetjak: Një kërcënim nga interesi vetjak ndodh kur një interes financiar ose interes tjetër ndikon në mënyrë të papërshtatshme në gjykimin ose sjelljen e kontabilistit. Në këtë rast, rritja e pagës së kontabilistit ka ndikuar në sjelljen e tij.
- Frikësimi: Kjo rezulton nga ndikimi i tepruar i drejtorit ekzekutiv.

Skenari 2

- Interesi vetjak: Një kërcënim nga interesi vetjak ndodh kur një interes financiar ose interes tjetër ndikon në mënyrë të papërshtatshme në gjykimin ose sjelljen e kontabilistit. Në këtë rast, tarifa për angazhimin ka ndikuar në sjelljen e tij.

Skenari 3

- Interesi vetjak: Një kërcënim nga interesi vetjak ndodh kur një interes financiar ose interes tjetër ndikon në mënyrë të papërshtatshme në gjykimin ose sjelljen e kontabilistit. Në këtë rast, avantazhi financiar për gruan e tij ka ndikuar në sjelljen e tij.
- Avokimi: Ky kërcënim ndodh kur menaxheri financiar po e promovon punëdhënësin deri në një pikë ku kompromentohet objektiviteti i tij (p.sh., duke promovuar aksione të një njësie të listuar në bursë që është kliente e gruas së tij).

3.

a) Janina sh.a operon brenda industrisë së ushqimit në Epir. Më 1 janar 2023, kompania u pajtua të japë nga 10,000 aksione për secilin prej 500 punonjësve, me kusht që punonjësit të mbeten në punësim tek kompania gjatë periudhës së përfitimit. Kushtet e skemës tregonin se aksionet do të përfitohen në:

- i) 31 dhjetor 2023, nëse rritja e FPA-së e kompanisë është më e madhe se 18%.
- ii) 31 dhjetor 2024, nëse rritja e FPA-së e kompanisë është më e madhe se mesatarja prej 13% në vit gjatë periudhës 2-vjeçare.
- iii) 31 dhjetor 2025, nëse rritja e FPA-së e kompanisë është më e madhe se mesatarja prej 10% në vit gjatë periudhës 3-vjeçare.

Vlera e brendshme [aktuale] u vlerësua të kishte një vlerë të drejtë prej €8 për aksion në datën e akordimit. Ngjarjet e mëposhtme ndodhën gjatë tre viteve në:

31 dhjetor 2023: FPA-ja u rrit me 14% dhe 30 punonjës u larguan. Kompania priste që FPA-ja të vazhdonte të rritej në të njëjtin nivel dhe për rrjedhojë që aksionet të përfitoheshin më 31 dhjetor 2024. Pritej që 30 punonjës të tjerë të largoheshin në vitin 2024.

31 dhjetor 2024: FPA-ja u rrit vetëm me 10%, prandaj aksionet nuk u përfituan. 28 punonjës u larguan gjatë vitit. Kompania priste që 25 punonjës të tjerë të largoheshin në vitin 2025 dhe që FPA-ja do të rritej me më shumë se 6%, duke arritur kështu një normë mesatare rritjeje të FPA-së prej 10% në vit.

31 dhjetor 2025: 23 punonjës u larguan dhe FPA-ja u rrit me 8%. FPA-ja mesatare gjatë periudhës trevjeçare ishte më e madhe se 10%.

Kërkohe:

Rekomandoni se si Janina sh.a do ta trajtonte skemën e pagesave të bazuara në aksione gjatë viteve që përfunduan më 31 dhjetor 2023, 2024 dhe 2025. Tregoni vetëm ekstrakte nga pasqyrat financiare të vitit 2024. (8 pikë)

b) Presheva sh.a ka tri njësi gjeneruese të parasë, një zyre qendrore dhe një qendër të hulumtimit.

Vlerat kontabël të pasurive dhe shumat e tyre të rikuperueshme janë si më poshtë:

	Njësia X €m	Njësia Y €m	Njësia Z €m	Zyra qendrore €m	Qendra e hulumtimit €m	Presheva sh.a €m
Shuma bartëse	500	700	1,000	750	250	3,250
Shuma e rikuperueshme	645	820	1,355	-	-	2,920

Pasuritë e zyrës qendrore mund të alokohen në mënyrë të arsyeshme në tre njësi si më poshtë:

- Njësia X: €95m
- Njësia Y: €280m
- Njësia Z: €375m

Pasuritë e qendrës së hulumtimit nuk mund të alokohen në mënyrë të arsyeshme tek njësitë gjeneruese të parasë.

Kërkohet:

Duke supozuar se të gjitha pasuritë mund të korigjohen për dëmtim, tregoni se si duhet të përcaktohen vlerat kontabël të rishikuara/korigjuara të pasurive të Presheva sh.a në përputhje me SNK 36 *Dëmtimi i pasurive* pasi të merren parasysh humbjet nga dëmtimi në skenarin e mësipërm. Tregoni ekstraktet përkatëse të pasqyrave financiare. (7 pikë)

c) Manastiri sh.a negocion me linjat ajrore kryesore vendase dhe ndërkombëtare për të blerë bileta me çmime të reduktuara krahasuar me çmimin e biletave të shitura direkt nga linjat ajrore për publikun. Manastiri sh.a pranon të blejë një numër specifik biletash dhe duhet të paguajë për ato bileta pavarësisht nëse është në gjendje t'i rishesë ato. Çmimi i reduktuar i paguar nga Manastiri sh.a për çdo biletë të blerë negociohet dhe dakordësohet paraprakisht. Manastiri sh.a përcakton çmimet me të cilat biletat e avionit do t'u shiten klientëve të saj. Manastiri sh.a shet biletat dhe arkëton pagesat nga konsumatorët kur ata i blejnë biletat. Kompania gjithashtu ndihmon klientët në zgjidhjen e ankesave me shërbimin e ofruar nga linjat ajrore. Megjithatë, çdo linjë ajrore është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me biletën, duke përfshirë dëmshpërblimin për një klient për pakënaqësi me shërbimin.

Kërkohet:

Në përputhje me SNRF 15 *Të hyrat nga kontratat me konsumatorët*, shpjegoni nëse Manastiri sh.a është një drejtor apo agjent dhe tregoni se si do të përcaktonte shumën e të hyrave që do të njihen nga shitjet e biletave. (5 pikë)

(Total: 20 pikë)

3.
a)

Më 31 dhjetor 2023, kemi të dhënat e mëposhtme:

- Aksionet pritet të përfitohen në vitin 2024 (sepse mesatarja e rritjes aktuale të FPA-së në vitin 2023 [14%] dhe rritjes së pritur të FPA-së në vitin 2024 [14%] është më e madhe se 13%))
- Numri i punonjësve që u larguan në vitin 2023 është i barabartë me 30;
- Stafi shtesë që pritet të largohet deri në datën e përfitimit (p.sh., 31 dhjetor 2024) = 30; Aksionet që pritet të përfitohen për $500 - 30 - 30 = 440$ punonjës

Më 31 dhjetor 2024, kemi të dhënat e mëposhtme:

- Aksionet nuk u përfituan në vitin 2024 sepse rritja aktuale e FPA-së në vitin 2024 (10%) nënkuptonte se rritja mesatare gjatë viteve 2023 dhe 2024 është më pak se 13%.
- Aksionet që tani pritet të përfitohen në vitin 2025 (sepse mesatarja e rritjes aktuale të FPA-së në vitet 2023 dhe 2024 dhe rritja e pritur e FPA-së në vitin 2025 është më e madhe se 10% [shih kushtet e përfitimit])
- Numri i punonjësve që u larguan në vitin 2023 = 30; Numri i atyre që u larguan në vitin 2024 = 28
- Stafi shtesë që pritet të largohet deri në datën e përfitimit (domethënë, 31 dhjetor 2025) = 25; Aksionet që pritet të përfitojnë nga $500 - 30 - 28 - 25 = 417$ punonjës

Më 31 dhjetor 2025, kemi të dhënat e mëposhtme:

- Aksioneve përfitohen në vitin 2025 sepse rritja aktuale e FPA-së në vitin 2025 (8%) do të thotë që rritja mesatare aktuale gjatë tre viteve të fundit tejkalon 10% (shih kushtet e përfitimit)
- Numri i punonjësve që u larguan në vitin 2023 = 30; Numri i atyre që u larguan në vitin 2024 = 28; Numri i atyre që u larguan në vitin 2025 = 23; Opsionet e aksioneve në fakt përfitohen nga $500 - 30 - 28 - 23 = 419$ punonjës.

	Llogaritja	Shpenzimet kumulative (ekuiteti) €000	Ngarkesa për vitin €000
2023	$10,000 \times 440 \times 8 \times 1/2$	17,600	17,600
2024	$10,000 \times 417 \times 8 \times 2/3$	22,240	4,640
2025	$10,000 \times 419 \times 8 \times 3/3$	33,520	11,280

Janina sh.a

Pasqyra e fitimit ose humbjes (ekstrakt) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

€'000
Kostot e punonjësve (4,640)

Janina sh.a

Pasqyra e pozitës financiare (ekstrakt) me 31 dhjetor 2024

€'000
Ekuiteti
Opsionet e aksioneve 22,240

b) Për secilën njësi gjeneruese të parasë, kërkohet një krahasim midis vlerave kontabël dhe shumave të rikuperueshme të pasurive të njësisë gjeneruese të parasë për të përcaktuar se cila, nëse ka, nga njësitë gjeneruese të parasë është e dëmtuar. Meqenëse pasuritë e zyrës qendrore mund t'i alokohen secilës prej njësive, vlerat kontabël të secilës prej njësive gjeneruese të parasë duhet të përfshijnë pjesën e alokuar të zyrës qendrore.

Alokimi i pasurive të zyrës qendrore te njësitë gjeneruese të parasë (€'m)

	Njësia X	Njësia Y	Njësia Z
Shuma bartëse	500	700	1,000
Pasuritë e zyrës qendrore	95	280	375
	595	980	1,375

Llogaritja e humbjeve nga dëmtimi për njësitë gjeneruese të parasë (€'m)

	Njësia X	Njësia Y	Njësia Z
Shuma bartëse	595	980	1,375
Shuma e rikuperueshme	645	820	1,355
Humbja nga dëmtimi	0	160	20

Meqenëse pasuritë e Njesisë X nuk janë të dëmtuara, nuk është e nevojshme të bëhet shlyerje. Për Njësiti Y dhe Z, humbjet nga dëmtimi duhet të alokohen në pasuritë e njësive. Shpërndarja është në përpjesëtim me vlerat kontabël të pasurive.

Alokimi i humbjeve nga dëmtimi (€'m)

	Njësia Y		Njësia Z	
Te zyra qendrore	[160 x 280/980]	46	[20 x 375/1,375]	5
Te pasuritë tjera	[160 x 700/980]	114	[20 x 1,000/1,375]	15
Humbja nga dëmtimi		160		20

Në lidhje me qendrën e hulumtimit, pasuritë e qendrës nuk mund t'u ndahen njësive, kështu që testi i dëmtimit bazohet në njësinë gjeneruese të parasë më të vogël që përmban qendrën e hulumtimit, e cila në këtë rast është njësia në tërësi, Presheva sh.a. Për këtë llogaritje, vlerat kontabël të pasurive të njësive, si dhe të zyrës qendrore, zvogëlohen me humbjet nga dëmtimi që janë tashmë të alokuara. Totali i pasurive të Presheva sh.a përbëhet nga të gjitha pasuritë e njësisë.

Testimi i dëmtimit për Presheva sh.a në tërësi dhe vlerat kontabël të rishikuara (€'m)

	Shuma bartëse	Përpjestimi	Alokimi i humbjes	Shuma bartëse e korigjuar
Njësia X	500	500/3,020 x 100	17	483
Njësia Y (700-114)	586	586/3,020 x 100	19	567
Njësia Z (1,000-15)	985	985/3,020 x 100	33	953
Zyra qendrore (750-46-5)	699	699/3,020 x 100	23	676
Qendra e hulumtimit	250	250/3,020 x 100	8	242
	3,020		100	2,920

Shënim: Alokimi i humbjes = 3,020 - 2,920 = 100

c)

- Për të përcaktuar nëse detyrimi i performancës së Manastiri sh.a-së është të ofrojë vetë mallrat ose shërbimet e specifikuar (domethënë, Manastiri sh.a është një palë drejtuese) apo të aranzhoj që këto mallra ose shërbime të ofrohen nga një palë tjetër (domethënë, Manastiri sh.a është një agjent), kompania identifikon mallin ose shërbimin e specifikuar që do t'i ofrohet konsumatorit dhe vlerëson nëse e kontrollon atë mall ose shërbim përpara se malli ose shërbimi t'i transferohet konsumatorit.
- Mund të konkludohet se, me çdo biletë që Manastiri sh.a zotohet ta blejë nga linja ajrore, Manastiri sh.a merr kontrollin e një të drejte për të fluturuar në një fluturim të specifikuar (në formën e një bilete) që Manastiri sh.a më pas ia transferon njërit prej konsumatorëve të saj (shih paragrafin B35A(a) të SNRF 15).
- Si pasojë, mund të përcaktohet se malli ose shërbimi i specifikuar që do t'i ofrohet konsumatorit të saj është ajo e drejtë (për një vend në një fluturim specifik) që Manastiri sh.a kontrollon.
- Manastiri sh.a nuk i premtton mallra ose shërbime të tjera konsumatorit
- Manastiri sh.a kontrollon të drejtën për çdo fluturim përpara se ta transferojë atë të drejtë të specifikuar te një prej konsumatorëve të saj, sepse Manastiri sh.a ka aftësinë të drejtojë përdorimin e asaj të drejte duke vendosur nëse do ta përdorë biletën për të përmbushur një kontratë me një konsumator dhe, nëse po, cilën kontratë do ta përmbushë.
- Manastiri sh.a gjithashtu ka aftësinë të marrë përfitimet e mbetura nga kjo e drejtë duke rishitur biletën dhe duke marrë të gjitha të ardhurat nga shitja ose, si alternativë, duke përdorur vetë biletën.
- Manastiri sh.a ka rrezik të stoqeve në lidhje me biletën, sepse është zotuar ta marrë biletën nga linja ajrore përpara se të marrë një kontratë me një konsumator për të blerë biletën. Kjo ndodh sepse Manastiri sh.a është i detyruar t'i paguajë linjës ajrore për këtë të drejtë pavarësisht nëse është në gjendje të sigurojë n konsumatorit për t'ia rishitur biletën ose nëse mund të marrë një çmim të favorshëm për biletën. Manastiri sh.a gjithashtu përcakton çmimin që klienti do të paguajë për biletën e specifikuar.
- Kështu, Manastiri sh.a konsiderohet si një drejtor në transaksionet me konsumatorët. Kompania njih të hyra në shumën bruto të pagesës për të cilën ka të drejtë në këmbim të biletave të transferuara te konsumatorët.

4.

a) Korça sh.a është një entitet i diversifikuar i listuar në Bursën e Ilirisë. Viti i saj financiar përfundon më 31 dhjetor 2025.

Më 1 korrik 2025, Ismail Qemali, Drejtori Ekzekutiv i Berati sh.a-së siguroi fonde prej €65 milionë për një projekt zgjerimi të Mitrovica sh.a-së, një kompani filiale e Korça sh.a-së. Berati sh.a mbante 52% të aksioneve me të drejtë vote të Korça sh.a-së më 31 dhjetor 2025. Ismail Qemali nuk mban pozicione drejtuese në bordet e Korça sh.a-së ose Mitrovica sh.a-së. Mitrovica sh.a emetoi aksione me vlerë €65 milionë për Ismail Qemali më 20 janar 2026 për të shlyer shumën që i kishte borxh atij.

Kërkohe:

Tregoni palët e ndërlidhura për pasqyrat financiare të Korça sh.a-së nga faktet e mësipërme për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025 dhe kërkesat e shpalosjes për palët e ndërlidhuara të identifikuar sipas SNK 24 Shpalosjet e palëve të ndërlidhuara. (5 pikë)

b) Shkodra sh.a vendosi të shesë një nga fabrikat e saj kryesore të prodhimit, e cila ishte bërë e tepërt për të përmbushur nevojat. Më 30 qershor 2025, të gjitha kriteret ishin përmbushur që fabrika të klasifikohet si e mbajtur për shitje. Më 31 dhjetor 2025, kishte prova materiale se plani origjinal i shitjes do të ndryshonte dhe për këtë arsye, u konsiderua e papërshtatshme të mbahej fabrika si e mbajtur për shitje. Fabrika mbahet sipas modelit të koston.

Detajet fabrikës janë si më poshtë:

	€ milion
Kosto - e blerë me 1 janar 2023	20.0
Norma e zhvlerësimit (drejtvizore deri në vlerën e mbetur zero)	10%
Me 30 qershor 2025:	
Vlera e drejtë	14.0
Kosto për ta shitur	0.4
Me 31 dhjetor 2025:	
Shuma e rikuperueshme	15.2

Kërkohe:

Në përputhje me SNRF 5 Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera, rekomandoni se si do të trajtohej fabrika në pasqyrat financiare të Shkodra sh.a-së për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025. (5 pikë)

c) SNRF 8 Segmentet Operative përcakton kërkesat për shpalosjen e informacionit në lidhje me segmentet operative të një entiteti dhe gjithashtu në lidhje me produktet dhe shërbimet e entitetit, zonat gjeografike në të cilat operon dhe klientët e saj kryesorë.

Ulqini sh.a tregton në katër fusha biznesi të cilat raportohen veçmas në pasqyrat e saj të brendshme të ofruara për vendimmarrësin kryesor operativ. Katër segmentet operative janë pjesët e veturave, softuerët, elektronika dhe kozmetika.

Informacioni i segmenteve operativ më 31 dhjetor 2025 është si më poshtë::

Segmentet operative	Total Të hyrat (€ milion)	Fitimi/humbja e segmentit (€ milion)	Pasuritë e segmentit (€ milion)	Detyrimet e segmentit (€ milion)
Pjesët e veturave	67	11	118	77
Softuerët	10	(2)	18	11
Elektronika	12	1	19	10
Kozmetika	<u>47</u>	<u>(6)</u>	<u>54</u>	<u>33</u>
Total	136	4	209	131

Kërkohet:

- i) Shpjegoni se çfarë nënkuptojnë termat “Segment operativ” dhe “Segment i raportueshëm” sipas SNRF 8 *Segmentet Operative* (6 pikë)
- ii) Diskutoni se cilët nga segmentet operative të Ulqini sh.a përbëjnë një segment operativ “të raportueshëm” sipas SNRF 8 *Segmentet Operative* për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025. (4 pikë)

4.

a) Palët e ndërlidhura të Korça sh.a janë:

- Ismail Qemali (një personel kyç menaxhues i kompanisë prind të Korça sh.a-së)
- Mitrovica sh.a (Filiale e Korça sh.a-së)
- Berati sh.a (kompanisë prind të Korça sh.a-së)

Marrëdhëniet midis një kompanie prind dhe filialeve të saj duhet të shpalosen pavarësisht nëse ka pasur transaksione midis tyre. Një entitet duhet të shpalos emrin e kompanisë prind dhe, nëse është i ndryshëm, palën kontrolluese përfundimtare.

Nëse një entitet ka pasur transaksione me palë të ndërlidhura gjatë periudhave të mbuluara nga pasqyrat financiare, ajo duhet të shpalos natyrën e marrëdhënies me palët e ndërlidhura, si dhe informacionin rreth këtyre transaksioneve dhe saldove të papaguara, duke përfshirë kushtet dhe zotimet e nevojshme që përdoruesit të kuptojnë efektin e mundshëm të marrëdhënies në pasqyrat financiare.

Në këtë rast, shpalosjet e mësipërme të kërkuara duhet të bëhen veçmas për secilën nga kategoritë e mëposhtme.

- Kompania prind
- Filiali
- Personeli kryesor të menaxhimentit të entitetit ose kompanisë prind të saj

b)

Shkodra sh.a

Pasqyra e fitimit ose humbjes (ekstrakt) për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

	€'million
Zhvlerësimi	(1)
Dëmtimi	(1.4)
Fitimi në riklasifikim	0.4

Shkodra sh.a

Pasqyra e pozitës financiare (ekstrakt) me 31 dhjetor 2025

	€'million
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>	
Fabrika	14

Llogaritjet

1.

	€'million
Kosto - blerë me 1 janar 2023	20
Zhvlerësimi: 1 janar 2023- 31 dhjetor 2024 (10% x 20 m x 2)	<u>(4)</u>
Shuma bartëse me 31 dhjetor 2024	16
Zhvlerësimi: 1 janar 2025- 30 qershor 2025 (10% x 20 m x 6/12)	<u>(1)</u>
Shuma bartëse me 30 qershor 2025	15
Humbja nga dëmtimi	<u>(1.4)</u>
Me 30 qershor 2025:	
Vlera e drejtë minus kosto për ta shitur	13.6
Fitimi në riklasifikim (saldo balancuese)	<u>0.4</u>
Me 31 dhjetor 2025: shuma bartëse e riparaqitur (shih më poshtë)	14

2.	€ milion
Kosto – blerë me 1 janar 2023	20
Zhvlerësimi i akumuluar që do të ishte kërkuar: me 1 janar 2023 – 31 dhjetor 2025 (10% x 20 m x 3)	<u>(6)</u>
Shuma bartëse me 31 dhjetor 2025 do të ishte (A)	14
Shuma e rikuperueshme me 31 dhjetor 2024 (B)	15.2
Fabrika do të riparaqitet në vlerën më të ulët midis A dhe B:	14

Shënim:

SNRF 5 kërkon që një pasuri e mbajtur për shitje të rimartet fillimisht në vlerën e saj kontabël duke përdorur standardin ekzistues të kontabilitetit. Më pas, pasuria duhet të mbahet me vlerën më të ulët midis vlerës së saj kontabël dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe nuk do të ngarkohet me ndonjë zhvlerësim të mëtejshëm. Çdo humbje e kërkuar nga dëmtimi i ngarkohet fitimit ose humbjes.

Kur pasuria e mbajtur për shitje nuk i plotëson më kriteret e klasifikimit, SNRF 5 kërkon një rishikim të vlerës kontabël të pasurisë bazuar në vlerën më të ulët midis vlerës së saj kontabël pa klasifikimin fillestar dhe shumës së rikuperueshme në atë datë. Kjo mund të rezultojë në njohjen e fitimit ose humbjes, e cila duhet të raportohet brenda fitimit ose humbjes.

c)

(i) Segment operativ dhe Segment i raportueshëm

SNRF 8 *Segmentet Operative* Perkufizon një segment operativ si në vijim.

Segment operativ: Ky është një komponent [përbërës] i një entiteti:

- I cili merret me aktivitete biznesi nga të cilat mund të gjenerohen të hyra dhe të ndodhin shpenzime (përfshirë të hyrat dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me transaksionet me komponentë [përbërës] të tjerë të të njëjtit entitet)
- Rezultatet operative të të cilit rishikohen rregullisht nga vendim – marrësit kryesorë operativë [ekzekutivë] të entitetit të cilët marrin vendime për sa i takon burimeve që do të duhet të shpërndahen ndaj segmentit dhe vlerësojnë performancën e tij, dhe
- Për të cilin janë në dispozicion informacione financiare të veçanta.

SNRF 8 kërkon që një entitet të raportojë informacion financiar dhe përshkruet në lidhje me segmentet e saj të raportueshme. Segmentet e raportueshme janë segmente operative ose agregime të segmenteve operative që tejkalojnë së paku njërën nga kufijtë e mëposhtëm kuantitativ:

- Të hyrat e raportuara janë 10% apo më shumë se sa të hyrat e kombinuara të të gjithë segmenteve operative (të jashtme dhe ndërsegmentale), ose
- Shuma absolute e fitimit dhe humbjes së tij të raportuar është 10% ose më shumë së më e larta e, në shumën absolute, të gjithë segmenteve që nuk raportojnë humbje, dhe të gjithë segmenteve që raportojnë humbje, ose
- Pasuritë e tij janë 10% ose më shumë së total pasuritë e të gjithë segmenteve operative.

Nëse të ardhurat totale të jashtme të raportuara nga segmentet operative përbëjnë më pak se 75 % të të hyrave të entitetit, segmente të tjera operative duhet të identifikohen si segmente të

raportueshme (edhe nëse nuk i plotësojnë kufinj të kuantitativ të përcaktuar më sipër) derisa të paktën 75 % e të hyrave të entitetit të përfshihet në segmentet e raportueshme.

(ii) Më 31 dhjetor 2025, tre nga katër segmentet operative janë segmente operative të raportueshme:

- Segmentet e Pjesëve të veturave dhe Kozmetikës plotësojnë përkufizimin në të gjitha kriteret e madhësisë.
- Segmenti i softuerit raportohet veçmas për shkak se humbja e tij është më e madhe se 10% e totalit të segmenteve në fitim (2/12 ose 16.7%).
- Segmenti i elektronikës përfaqëson 8.8% të të ardhurave, humbja është 8.3% e “numrit krahasues” të, në këtë rast, segmenteve operative në fitim (1/12) dhe 9% të totalit të pasurive.

Edhe pse segmenti i elektronikës bie nën pragjet e 10%, ai prapë mund të raportohet si një segment operativ i veçantë nëse menaxhmenti beson se informacioni rreth segmentit do të ishte i dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare. Si alternativë, Ulqini sh.a mund të marrë në konsideratë bashkimin e tij me segmentin e softuerit, duke siguruar që dy segmentet operative të kenë karakteristika të ngjashme ekonomike dhe të ndajnë shumicën e kriterëve të “agregimit”, gjë që mund të jetë rasti. Përndryshe, do të shpalosej në një kolonë “Të gjithë segmentet e tjerë”.

5.

a) Podujeva sh.a është një kompani investimi, modeli i biznesit të së cilës përfshin sigurimin e fondeve nga investitorë si në aksione ashtu edhe në borxhe dhe kanalizimin e fondeve në një gamë instrumentesh investimi.

Më 1 janar 2024, Podujeva sh.a bleu 2 milionë obligacione me vlerë nominale prej €1 secila në Kruja sh.a me një zbritje prej 5%. Tarifat e ndërmjetësit të paguara nga Podujeva sh.a arritën në €0.2 milionë. Obligacionet kanë një normë kuponi prej 12% dhe pagesat e interesit kontraktual duhet të paguhen më 31 dhjetor të çdo viti. Ato maturohen më 31 dhjetor 2027 dhe janë të ripagueshme me vlerën nominale në maturim.

Modeli i biznesit të Podujeva sh.a në lidhje me klasën e pasurive të cilave u përkasin obligacionet është mbajtja e tyre deri në maturim në mënyrë që të mblidhen rrjedhat e kontraktuara të parasë. Norma efektive e interesit fillestar mbi obligacionet është 10.41%. Bazuar në vlerësimin se aftësia kreditore e Kruja sh.a-së nuk ishte përkeqësuar që nga 1 janari 2024, Podujeva sh.a kishte raportuar një rezervë të humbjeve të pritura kreditore për obligacionet në vlerë prej €0.15 milion më 31 dhjetor 2024.

Më 31 dhjetor 2025, vlerësimi i Podujeva sh.a-së është se aftësia kreditore e Kruja sh.a-së është përkeqësuar nën nivelin e 1 janarit 2024 (rreziku kreditor është rritur në mënyrë të rëndësishme), pavarësisht se nuk ka pasur mospagesa (vonesa) deri më 31 dhjetor 2025. Duke rivlerësuar matjen e rezervës së humbjeve të pritura kreditore më 31 dhjetor 2025, Podujeva sh.a ka vlerësuar shpërndarjen e mëposhtme të probabilitetit në lidhje me rrjedhat e parashikuara të parave të arkëtueshme nga obligacioni në të ardhmen:

Data (31 dhjetor)	Natyra e rrjedhave të parasë	Arkëtimet e mundshme (€'m)	Probabiliteti (%)
2026	Interesi	0.24	75
	Interesi	0.20	20
	Interesi	0.18	5
2027	Interesi	0.24	80
	Interesi	0.19	15
	Interesi	0.16	5
	Kryegjësja	2.00	75
	Kryegjësja	1.90	20
	Kryegjësja	1.85	5

Të gjitha pagesat e kaluara të kuponave deri më 31 dhjetor 2025 janë arkëtuar plotësisht.

Faktorët e skontimit për normen prej 10.41% për 1 vit dhe 2 vite janë 0.9057 dhe 0.8203.

Kërkohe:

Këshillo drejtorët e Podujeva sh.a-së mbi trajtimin kontabël të obligacionit për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025, në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*. (10 pikë)

b) Plava sh.a është e vendosur në Kosovë dhe ka Euron (€) si valutë funksionale. Më 1 janar 2025, Plava sh.a bleu 4 milionë aksione (2% e totalit të aksioneve) në Peshkopia sh.a, një kompani me seli në Shqipëri, me një çmim prej 2.5 Lekë Shqiptar (ALL) për aksion. Çmimet e aksioneve të Peshkopia sh.a-së, kuotohen në ALL. Tarifat e ndërmjetësit të paguara nga Plava sh.a në lidhje me transaksionin arritën në 0.1 milion ALL. Më 1 tetor 2025, Plava sh.a mori një dividend nga Peshkopia sh.a në shumën 1.5 milion ALL. Çdo aksion i Peshkopia sh.a kuotohet me një çmim prej 3.1 ALL më 31 dhjetor 2025.

Investimi në aksionet e Peshkopia sh.a është një pasuri (instrumenti i ekuitetit) jo për tregtim për të cilin është bërë një zgjedhje e parevokueshme për ta përcaktuar pasurinë në njohjen fillestare sipas vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirës në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*.

Kurset e mëposhtme të këmbimit gjatë vitit deri më 31 dhjetor 2025 janë si në vijim:

Data	Kursi i këmbimit (EUR për 1 ALL)
1 janar 2025	1.20
1 tetor 2025	1.28
31 dhjetor 2025	1.40
Mesatarja për v/p 31 dhjetor 2025	1.32

Kërkohet:

Këshilloni drejtorët e Plava sh.a-së mbi trajtimin kontabël të investimit të mësipërm në aksionet e Peshkopia sh.a në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare* dhe SNK 21 *Efektet e ndryshimeve në kursin e këmbimit të valutave të huaja*. (10 pikë)

[Total 20 pikë]

5.

a)

Kjo është një pasuri (instrument borxhi) me rrjedha të parave të paracaktuara kontraktuale sa i përket kryegjësë dhe interesit dhe për të cilin modeli i biznesit është të realizojë rrjedhat e parave të kontraktuara. Prandaj, pasuria do të matet sipas kostos së amortizuar sipas SNRF 9 *Instrumentet Financiare*. Pasuria do të matet fillimisht me vlerën e drejtë (çmimi i blerjes) duke përfshirë kostot e transaksionit. Më pas, pasuria do të matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Gjithashtu, pasuria do t'i nënshtrohet kërkesave të HPK-ve për humbjet nga dëmtimi të SNRF 9 *Instrumentet Financiare*. Meqenëse aftësia kreditore e palës tjetër është përkeqësuar, Podujeva sh.a tani duhet të masë lejimin e humbjes duke parashikuar mospagime të mundshme gjatë gjithë afatit të mbetur deri në maturim.

Shumat që do të raportohen në pasqyrat financiare për vitin deri më 31 dhjetor 2025 do të llogariten si më poshtë:

Shuma bartëse bruto me 31 dhjetor 2025:	€'m
Shuma bartëse fillestare me 1 janar 2024 ($2 \times 0.95 + 0.2$)	2.100
E ardhura financiare për v/p me 31 dhjetor 2024 ($10.41\% \times 2.10$)	0.219
Paraja e arkëtuar me 31 dhjetor 2024 ($12\% \times 2 \times \text{€}1$)	<u>-0.240</u>
Shuma bartëse bruto me 1 janar 2025	2.079
E ardhura financiare për v/p me 31 dhjetor 2025 ($10.41\% \times 2.08$)	0.216
Paraja e arkëtuar me 31 dhjetor 2025 ($12\% \times 2 \times \text{€}1$)	<u>-0.24</u>
Shuma bartëse me 31 dhjetor 2025	2.055

Lejimi për humbjet e pritura kreditore me 31 dhjetor 2025:

Shuma bartëse bruto me 31 dhjetor 2025	2.055
Shuma e pritur e rikuperueshme (llogaritjet më poshtë)	<u>-2.01</u>
Lejimi për humbjet e pritura kreditore me 31 dhjetor 2025	0.05

Llogaritjet - Shuma e pritur e rikuperueshme me 31 dhjetor 2025

Data	Rrjedhat e pritura të parasë	FS	VT - €'m
31 dhjetor 2026	$(0.24 \times 0.75 + 0.2 \times 0.2 + 0.18 \times 0.05)$	0.9057	0.207
31 dhjetor 2027	$(0.24 \times 0.8 + 0.19 \times 0.15 + 0.16 \times 0.05 + 2 \times 0.75 + 1.9 \times 0.2 + 1.85 \times 0.05)$	0.8203	<u>1.806</u>
Shuma e pritur e rikuperueshme me 31 dhjetor 2025			2.013

b)

Investimi në aksionet e Peshkopia sh.a-së është një pasuri financiare (instrumenti i ekuitetit) jo për tregtim për të cilin është bërë një zgjedhje e parevokueshme për ta përcaktuar pasurinë si VDNTTGj (SNRF 9). Prandaj, pasuria fillimisht do të matet me vlerën e drejtë duke përfshirë kostot e transaksionit, të përkthyer me kursin e këmbimit në datën e blerjes. Më pas, pasuria do të rimatet në vlerën e drejtë çdo datë raportimi me fitimet dhe humbjet e

raportuara në TTGJ. Megjithatë, efektet e ripërktimit duhet të raportohen në fitim ose humbje.

Shumat që do të raportohen në pasqyrat financiare për vitin deri më 31 dhjetor 2025 do të llogariten si më poshtë:

	ALL'm	Kursi	€'m
Shuma bartëse fillestare me 1 janar (2.5 x 4 + 0.1)	10.1	1.2	12.120
Fitimi i rimatjes për t'u raportuar në TTGj për v/p me 31 dhjetor 2025 (12.4 - 10.1)	<u>2.3</u>	1.32	<u>3.036</u>
Shuma bartëse 31 dhjetor 2025 para ripërktimit	12.4		15.156
Fitimi i këmbimit do të raportohet në F/H	0		2.204
VD financiare duhet të raportohet si vlerë kontabël në PPF me 31 dhjetor 2025 (3.1 x 4)	12.4	1.4	17.36

Përveç kësaj, Plava sh.a do të raportojë të ardhura nga dividendët në F/H në vlerën **€1.92 milionë** (domethënë 1.5 ALL të përkthyer me kursin më 1 tetor 2025 prej €1.28/ALL).